REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr.7961 Prot

Lushnje, më 14/08 2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

"PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2026"

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.3, neni 29, pika 2, Ligjit 687/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 45, ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të R.Sh" I ndryshuar, neni 44 dhe 45 të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomise Nr.09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 4, neni 8 gërma "ç" neni 30 gërma "f", neni 42 gërma "b", neni 65 pika 2, VKM Nr.414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", VKM Nr.290, datë 17.05.2023 "Për një ndryshim në VKM Nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", pika 1 gërma "ë".

Nisur nga situatat e zjarreve në zonat kodrinore, për shkak të pamundësisë së kalimit të mjeteve të MZSH-së, është e domosdoshme hapja e rrugëve në këto zona, si pjesë e masave për mbrojtjen nga zjarri.

Për këtë arsye kërkojmë:

Miratimin e kalimit të fondit për blerjen e një automjetit të tipit buldozier, nga Fondi i Kushtëzuar i Emergjencave Civile për vitin 2026, me kod 21AD502, në vlerën e 6 500 00 (gjashtë million e pesëqind mijë) lek me TVSH.

Të blihet automjet buldozier me zinxhirë

- Vit prodhimi - jo më të vjetër se 2016
- Orët e punës - jo më shumë se 10.000 orë
- Fuqia motorrike - jo më pak se 97 Kw
- Gjatësia e thikës - jo më pakë se 3 ml
- Lloji i thikës - me krahë për zhvendosje anësore
- Pesha totale e lejuar - jo më pak se 15,000 kg
- Pajisje standarte sigurie
- Kabinë operatori e mbyllur
- Sisteme hidraulike funksionale për manipulimin e mjetit

Automjet buldozier me zinxhira dhe me dokumentacion teknik të plotë dhe të rregullt (Leje Qarkullimi, Targa, Kolaudim teknik, Siguracion).

Ju faleminderit!

DREJTOR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE

Edlira MEZINI

KRYETARE E BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 7961/1 Prot

Lushnje, më 14/08 2026

PROJEKT – VENDIM

NR. 72 DATË 14/08/2026

"PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2026"

Këshilli Bashkiak Lushnje, në mbledhjen e datës ___/___/2026, pasi të marri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori për Planifikim dhe Përballimin e Emergjencave civile, Sektori i MNZSH, NPP, në mbeshtetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore",neni 9 pika 1.3, neni 29, pika 2, neni 54, shkronja "dh", Ligjit 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore",neni 45,ligjit 9936,datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSh" i ndryshuar,neni 44, shkronja "a", të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomise Nr.09,datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit",ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile"neni 4,neni 8 gërma "ç"neni 30 gërma "f",neni 42 gërma"b",neni 65 pika 2,VKM Nr.414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtezuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile",VKM Nr.290,datë 17.05.2023 "Për një ndryshim në VKM Nr.414,datë 08.07.2021"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile",pika 3, shkronja "ë",

PROPOZOJMË :

1. Të miratohet përdorimi i fondit të kushtëzuar të Emergjencave Civile për blerjen e automjetit buldozier me zinxhirë në shumën 6 500 000 (gjashtë milion e pesëqindë mijë) Lek me TVSH.
2. Fondi për blerjen e këtij mjeti do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i Emergjencave Civile 2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Sektori për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile,
- Sektori i MZSH,
- Ndërmarja e Pasurisë Publike,
- Drejtoria e Finance-Buxhetit,
- Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve(zyra e prokurimeve).

4- Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

DREJTORI I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE

Edlira MEZINI

DREJTORI JURIDIK

Bedri HIDA

NDËRRMARJA E PASURISË PUBLIKE

Elson ZEKA

DREJTORI I FINANCW BUXHETIT

Ervisa ÇUKO

SEKTORI I MNZSH
Laver ALLA

KRYETARE
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË